



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0557

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), si dhe nenit 29 dhe 31 të Rregullores së Punës 01/2020 e amendamentuar 09. 08. 2023, në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Albo Group" SH.P.K., kundër Mosekzekutimit të vendimit të OSHP-së të Komunës së Suharekës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Vlerësimi rapid i shkollave - faza e parë" me numër të prokurimit 624-22-13949-2-2-1, me 27/11/2023, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE "Albo Group" SH.P.K. me nr. 2023/0557, e datës 09/08/2023, kurse vendimi i AK Komuna Suhareke lidhur me aktivitetin e prokurimit "Vlerësimi rapid i shkollave-faza e parë" me numër të prokurimit 624-22-13949-2-2-1. Aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Albo Group" SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 30.12.2022, Komunës së Suharekës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Vlerësimi rapid i shkollave- faza e parë" me numër të prokurimit 624-22-13949-2-2-1. Ndërsa me datën 27.07.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin ka anuluar aktivitetin e prokurimit pasi që nuk ka ofertë të përgjegjshme.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 20,000.00 €.

Me 28.07.2023, OE "Albo Group" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 03.08.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar

kërkesën për rishqyrtim.

Me 09.08.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Albo Group SH.P.K., me nr. 557/23 lidhur me aktivitetin “Vlerësimi rapid i shkollave - faza e pare” me nr. të prokurimit: 624-22-13949-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Albo Group” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

- **Pretendimi** Ankuesi pretendon se “*Pretendimi kryesor sipas ankesës nr.557/23 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së i njëjti nuk ka dëshmuar se plotëson kërkesën e dosjes për 20,000 projekte të ngjashme në tri vitet e fundit. Duke kërkuar nga OSHP që të nxjerr urdhëresë për nënshkrimin e kontratës me që një herë OSHP e ka kthyer lëndën në rivlerësim dhe AK për qëllime të tyre tenton ta bëjë anulim dhe nuk e zbaton vendimin e OSHP nr.2023/0176, njëherë kërkojmë të zbatohet edhe neni 131- i LPP-së.*”
- Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE Albo Group SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 25.8, 59, 60, 62, 69, 70, 130, 131 të LPP dhe shkeljet e dispozitave të Rregullores për Prokurim Publik duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 14/08/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 557/23, ndërsa me datë 25/08/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0557 me rekomandimet si në vijim: “*Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.*”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësit dhe

dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Albo Group” SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0557 ka vlerësuar si në vijim:

- **Pretendimi i parë (I) ankimor është i bazuar** pasi që *“AK në arsyetim të eliminimit konstaton se nga gjitha kontratat e prezantuara OE ankues, i njëjti ka vetëm një kontratë të ngjashme me këtë aktivitet të prokurimit, dhe atë kontrata në vlerë 3,540.00 me Universitetin Ukshin Hoti. Sqarojmë se ky arsyetim i AK-së për eliminim të OE ankues është identik si në rastin e ankesës 176/23, në të cilin rast si eksperti shqyrtues ashtu edhe paneli shqyrtues përmes vendimit 176/23 kanë konstatuar se AK-së ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 7, 59, 60, 62 të LPP-së, dhe nenin 40 të Rregullores Nr. 001/2022. Pas analizimit të pretendimeve ankimore, kërkesave të dosjes së tenderit, dhe vendimit të AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim vlerësojmë se AK-KK Suharekë ka vepruar në kundërshtim me vendimin e OSHP-së nr.176/23, pasi nuk ka dhënë asnjë arsyetim detaj lidhur me mos pranimin e shumicës së kontratave të OE ankues. Mendimi i ekspertit shqyrtues është se në rastin konkret nuk janë kërkuar projekte të njëjta, por janë kërkuar projekte të ngjashme, dhe qasja e AK-së duke eliminuar gjitha kontratat që nuk ndërlidhen me shkolla apo arsim pavarësisht përmbajtjes së tyre është e gabuar. Mendimi i ekspertit shqyrtues në rastin konkret është se OE ankues plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për 20.000 projekte të ngjashme. Vlen të ceket se mos respektimi i vendimeve të OSHP-së sipas rregullores për prokurim publik nr.001/2023 paraqet shkelje të rëndë të LPP-së”*.

-Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP lidhur me nenin 40 të RRPP.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit, është gjetur se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit Paneli Shqyrtues në OSHP me datë 29.06.2023 ka marrë edhe vendimin 176/23 përmes të cilit ka miratuar si të bazuar ankesën e operatorit ekonomik ankues “Albo Group” Sh.P.K. ndërsa aktivitetin e prokurimit e kishte kthyer në rivlerësim. Në pjesën e arsytimit të këtij vendimi ndër të tjera janë evidentuar edhe të gjeturat e Panelit Shqyrtues sipas të cilave pretendimi ankimor i parashtruar sipas ankesës 2023/0557 është i bazuar. Pra qysh në vendimin Psh.nr.176/23 është evidentuar se operatori ekonomik ankues “Albo Group” Sh.P.K. sipas ofertës së dorëzuar e ka përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit për projektet e realizuara në tri (3) vitet e fundit në vlerë së paku 20,000.00 euro. Nga ky këndvështrim, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin edhe raportit të ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0557 ku ndër të tjera thuhet se *“mendimi i ekspertit shqyrtues është se në rastin konkret nuk janë kërkuar projekte të njëjta, por janë kërkuar projekte të ngjashme, dhe qasja e AK duke eliminuar gjitha kontratat që nuk ndërlidhen me shkolla apo arsim pavarësisht përmbajtjes së tyre është e gabuar. Mendimi i ekspertit shqyrtues në rastin konkret është se OE ankues plotëson kërkesën e dosjes së tenderit”*. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet

ankimore sipas ankesës 2023/0557 janë pretendime të bazuara.

Me këtë rast Paneli Shqyrtues thekson faktin se vendimet e OSHP duhet të respektohen në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Në të kundërtën, mosrespektimi i vendimeve të OSHP përbën shkelje të rëndë ligjore dhe mund të sanksionohet sipas ligjit në fuqi për prokurimin publik si dhe legjislacionit përkatës sekondar.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet sie bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Suharekes. të datës 27.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Vlerësimi rapid i shkollave - faza e parë” me numër të prokurimit 624-22-13949-2-2-1, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në **Rivlerësim**.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veprojnë në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicojë procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - Albo Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: